



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E AUTORIT

---

## Aktiviteti i Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit për periudhën Janar-Dhjetor 2010.

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit ka zhvilluar këtë aktivitetet si më poshtë të detajuar për këtë periudhë:

### I. Strategjia Kombëtare e Zbatimit të Pronësisë Intelektuale

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 1.09.2010 është miratuar Strategjia Kombëtare e Zbatimit të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale. Qëllimi i SK është të sigurojë një nivel të njëjtë mbrojtjeje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale me atë të vendeve të Bashkimit European. Duke ju referuar MSA kjo duhet të ndiqet e arrihet me një harmonizim të kuadrit ligjor dhe kapaciteteve administrative në një sistem të të drejtave të Pronësisë intelektuale dhe Industriale. Ky dokument mbi të gjitha mbart rëndësi, pasi përfshin me detyrime konkrete disa struktura shtetërore me rol të posacëm në procesin e zbatimit të ligjeve për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me të si dhe për atë mbi Pronësinë Industriale.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 40, datë 18.03.2009 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës ndër-institucional për hartimin e një strategjie për pronësinë intelektuale” ZSHDA si institucioni i vetëm publik, përgjegjës për sa i takon të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Tjera të lidhura me të, pra Pronësisë Intelektuale, ka dhënë kontribut të vazhdueshëm dhe kryesor në hartimin e këtij dokumenti strategjik..

### II. Pyetëtori i Bashkimit European

- Dokumenti më i rëndësishëm dhe prioritar, jo vetëm për ZSHDA-në por edhe për Qeverinë Shqiptare, ka qënë hartimi i përgjigjeve për PyetëSORIN e Bashkimit European. Kapitulli 7 në këtë pyetëSOR ishte ai i Pronësisë Intelektuale me 29 pyetje e nën pyetje, ku e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të kishin më shumë se gjysmën e tij.
- Gjithashtu, po në vijim të pyetëSORIT, iu është dhënë përgjigje dhe 19 pyetjeve shtesë, që kanë ardhur për këtë fushë. Për përgjigjen e këtyre pyetjeve është marrë pjesë në vazhdimësi në tryeza pune në Ministrinë e Ekonomisë dhe në

Ministrinë e Integritit, ku janë miratuar apo debatuar variante të ndryshme të përgjigjeve.

### III- Projekti IPA 2008 ‘Asistencë për forcimin e kapaciteteve të ZSHDA’

-ZSHDA ka përfutur në kuadër të IPA 2008 një fond prej 800.000 EURO “Asistencë teknike për forcimin e kapaciteteve të ZSHDA”

-Projekti ka filluar zbatimin e tij ne 30 gusht 2010. Kompania fituese eshte nje Konsorcium i perbere nga Hyman Dynamics (Austri), ORDA (Rumani), EPLO (Greqi), SIPO(Slloveni. Kohezgjatja e tij do te jete 18 muaj dhe ka 3 komponente kryesore te zberhtyera ne 25 aktivitete.

-Projekti parashikon:

1- Përafrim legjislacioni

2-Trajnim të ZSHDA-së dhe të strukturave të tjera zbatuese të ligjit

3-Ndërgjegjësim për strukturat qeveritare, komunitetin e operatorëve ekonomikë/përdoruesë të PI si dhe të publikut të gjerë.

Në kuadër të **Projektit IPA 2008** janë parashikuar si dhe do te kryhen një sërë aktivitetesh trajnuese mjaft të larmishme dhe me tematika të gjera për stafin e ZSHDA-së, për stafet e Agjensive të Menaxhimit Kolektiv, për Organet shtetërore si tatime, dogana, polici, KKRT, për gjyqësorin dhe prokurorinë etj por dhe fushata sensibilizimi ne 12 qarqet me te medha administrative ne vend.

Në kuadër të projektit aktivitetet janë si me poshtë vijon per vitin 2010:

#### **Teknika legislative - Përputhje e misionit ekzistues të ZSHDA-së me praktikat më të mira të zyrave europiane të të drejtës së autorit.**

Është zhvilluar **Aktiviteti 1.1 “ Gap Analysis” – përputhje e misionit ekzistues të ZSHDA-së me praktikat më të mira të zyrave europiane të të drejtës së autorit.**

Në kuadër të aktivitetit të lartpërmendur të projektit, në datat 13-17 Dhjetor, asistuan dhe 4 ekspertët e parë në Zyrën Shqiptare për të drejtën e Autorit, emra te mirenjohur në arenën ndërkombëtare të pronësisë intelektuale si: Z. Mihaly Fiscor, Von Lewinski, Victor Nabhan, Dionyssiamrs Kallinikou -Drejtoresha e Zyrës greke të të drejtës së autorit (AEPO).

#### IV. Procesi i Regjistrim –Certifikimit të të drejtave dhe kontratave të kalimit të të drejtave.

Sa i takon punës që ka të bëjë me procedurat e Regjistrim-Certifikimit, të klasifikuar sipas klasave administrative rezultojnë këto shifra:

- Certifikim objekt veprimtarie 40 subjekte;
- Certifikim të drejtë autori 63 regjistrime;
- Certifikim kalim të drejtash 345 regjistrime;

-Si dhe një numër i madh refuzime certifikimi dhe njoftime të ndryshme për aplikimet e paplota të depozituara.

- Janë tërhequr nga subjekte të ndryshëm 38 344 Pulla, për fonogramet e prodhuara/shpërndara me të drejta.

#### V. Inspektimi dhe Monitorimi i tregut

Sa i takon Inspektimit dhe monitorimit të tregut rezultojnë këto shifra per 12-mujorin:

Viti 2010

<b>Tabelë Përmbledhëse të masave adm. Të marra në subjektet përdorues/prodhues/shpërndarës të pronësisë artistike 2010</b>									
<b>Subjekte</b>	<b>Botues</b>	<b>Radio</b>	<b>Tv./operat orë kabllore</b>	<b>Hotel</b>	<b>Vidiotek a/pikë shitje</b>	<b>Bar kafe/ pishi na</b>	<b>Prodhues/ qendra interneti etj</b>	<b>Nr.</b>	<b>Konfiskim</b>
<b>Janar</b>	0	0	0	0	<b>9</b>	0	<b>3</b>	<b>12</b>	<b>1834, copë CD DVD</b>
<b>Shkurt</b>	0	0	0	0	0	0	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>2500 CD</b>
<b>Mars</b>	0	0	0	0	<b>10</b>	0	0	<b>10</b>	<b>849 CD</b>
<b>Prill</b>	0	0	0	0	0	0	<b>2</b>	<b>2</b>	0
<b>Maj</b>	0	0	0	0	0	0	<b>1</b>	<b>1</b>	0
<b>Qeshor</b>	0	0	0	0	<b>1</b>	0	<b>6</b>	<b>7</b>	0
<b>Korrik</b>	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gusht</b>	0	0	0	0	0	<b>30</b>	<b>1</b>	<b>31</b>	0
<b>Shtator</b>	0	0	0	0	<b>1</b>	<b>11</b>	<b>2</b>	<b>14</b>	0
<b>Tetor</b>	0	0	0	0	0	<b>42</b>	0	<b>42</b>	0
<b>Nëntori</b>	0	<b>1</b>	0	<b>1</b>	0	<b>6</b>	0	<b>8</b>	0
<b>Dhjetor</b>	0	0	0	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>27</b>	<b>1</b>	<b>37</b>	<b>3820</b>

<b>Total</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>28</b>	<b>116</b>	<b>20</b>	<b>168</b>	<b>9003</b>
--------------	----------	----------	----------	----------	-----------	------------	-----------	------------	-------------

PROBLEMATIKË:

Subjekti SIG-SHIP: Gjatë monitorimit të tregut, është evidentuar që shumica e subjekteve bare-restorante dhe operatorë të tjerë tregtarë kanë paguar subjektin Sig-Ship, i cili kryen veprimtari të kundraligjshme dhe për të cilin është rihapur procesi penal.

Gjithashtu inspektorët e ZSHDA-së bënë identifikimin e selisë së subjektit SIG-SHIP, ndëshkimin me gjobë maksimale e këtij subjekti në masën 850 000 lekë, si dhe grumbullimin e provave të nevojshme për të iniciuar procedimin penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përvec këtyre masave administrative të ndërmarra nga ZSHDA, u sensibilizuan dhe një sërë organesh dhe institucionesh si MTKRS, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe strukturat e krimit ekonomik të kësaj ministrie dhe të Ministrisë së Brendshme, etj., për marrjen e masave emergjente ligjore ndaj këtij subjekti të kundërligjshëm, ***I CILI PREJ 3 VJETËSH VIJON TË CËNOJË RËNDË INTERESAT E MBAJTËSVE TË LIGJSHËM TË TË DREJTAVE QË JANË AGJENCITË E ADMINSTRIMIT KOLEKTIV.***

Administratori dhe përfaqësuesi i tij ligjor Ilir Muzhaqi, megjithëse u ndalua në flagrancë nga strukturat e Policisë së Shtetit, u la i lirë pasi Prokuroria e Rrethit Tiranë, vendosi në mënyrë të përsëritur pushimin e çështjes.

Aktualisht kemi kërkuar pranë Gjykatës Penale të Rrethit Gjyqësor Tiranë, rrëzimin e vendimit të pushimit të Prokurorit të çështjes dhe në datë 11.10.2010 u zhvillua séance e parë e gjykimit të çështjes, kundër këtij vendimi.

PROBLEMATIKË:

Tjetër problematikë e ndeshur gjatë punës së përditshme të ZSHDA-së është fakti që subjektet/ përdorues të pronësisë artistike rezultojnë me emra tregëtarë të ndryshëm nga ata ligjorë, gjë kjo e cila e bën shumë të vështirë identifikimin e tyre pranë QKR dhe rrjedhimisht dhe marrjen e informacionit për të identifikuar NIPT-et përkatëse të tyre, element ky shumë i domosdoshëm për formën ligjore të masave administrative/gjoha që Inspektorët e ZSHDA-së marrin gjatë konstatimeve të kundravajtjeve administrative në treg.

VI. Gjykimi/Administrimi i Ankesave dhe Padive me objekt të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura.

VI/a Proceset administrative:

Lidhur me këto procese, përmendim proceset administrative që vijnë nga viti 2009 dhe proceset administrative të nisura në vitin 2010, mbi bazën e kërkesave të reja ankimore.

-Kanë vijuar 4 procese administrative të nisura në vitin 2009, për të cilat ka përfunduar procedimi administrativ ku është pranuar (plotësisht ose pjesërisht) kërkesa e ankimesit përkatës-titullar i së drejtës së autorit/të drejtave të lidhura.

Në proceset administrative të nisura në vitin 2010, përmendim:

-Të paraqitura gjithsej: 5 kërkesa ankimore, nga të cilat janë përfunduar 2 procedime dhe të pezulluara 3 procedime me kërkesë të palëve.

#### VI/b. Proceset gjyqësore:

Lidhur me këto procese, përmendim proceset gjyqësore që vijnë nga viti 2009 dhe proceset e reja, të nisura në vitin 2010.

Në këto procese të cilat kanë qënë vetëm të natyrës civile, ZSHDA ka qënë në rolin e palës së tretë apo palës së paditur për kundërshtim të Shpjegimit Përfundimtar apo Fletë-Gjobës.

Gjatë vitit 2010, ZSHDA ka marrë pjesë në proceset gjyqësore:

-1 proces penal pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

-14 procese civile pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga të cilat është dhënë vendimi për 5 çështje;

-6 procese civile pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilat është dhënë vendimi nga kjo gjykatë.

#### VII. Monitorimi i Agjensive të Administrimit Kolektiv

-Është kryer kontrolli financiar i të ardhurave të krijuara nga agjencitë ekzistuese të të drejtave të autorit dhe shpërndarjes së tyre tek titullarët e të drejtës të autorit.

-Shqyrtimi i bilanceve reflektoi parregullsi tek agjensitë. Këto parregullsi u janë bërë me dije agjensive përkatëse në mënyrë të përsëritur.

-Agjencitë nuk kanë përmbushur dot detyrimin e mbledhjes së të ardhurave dhe me pas shpërndarjen e tyre në anëtarësinë që ata përfaqësojnë, kjo për shkak se të ardhurat e grumbulluara kanë shumë minimale dhe janë përdorur për funksionimin e agjensive.

-Vlen për t'u përmendur që agjencia "FMAA" është e vetmja e cila ka mundur të mbledhë një shumë të vogël dhe rrjedhimisht ka mundur të bëjë një shpërndarje modeste .

#### VIII. Integrimi europian dhe angazhimet e ZSHDA-së në kuadër të MSA

Sa i takon procesit të integritimit European, angazhimet e ZSHDA-së në fushën e aktivitetit të saj, burojnë nga:

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (Neni 73 Pronësia Intelektuale)  
Marrëveshja e Ndërmjetme (neni 39)  
Dokumenti i Partneritetit European  
Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA  
Progres Raportet e Shqipërisë

-Është kryer procesi i përditësimit të PKZMSA 2010-2014.

-Është përgatitur material i detajuar në kuadër të takimit të Komitetit të Stabilizim-Asociimit në 3 mars 2010 në Tiranë

-Takimi i Nën-komitetit për Tregun e Brendshëm në datë 29 prill 2010

-Përgatitur progres-raportet në kuadër të raportimit mbi progresin e Shqipërisë në procesin e integritimit.

#### IX. Bashkëpunimi me Organizatën Botërore të Pronësië Intelektuale (OBP)

Bashkëpunimi i ZSHDA-së me OBPI për vitin 2010 konsiderohet i sukseshëm. Është bërë e mundur që për vitin 2010 OBPI të mbështesë ZSHDA-në me 6 aktivitete të cilat janë:

##### Jane realizuar:

- Asistencë për hartimin e Ligjit të Ri për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tejtra të lidhura me të. (realizuar në datë 29 mars-1 prill 2010)
- 31 Mars 2010 është organizuar një seminar kombëtar "**Workshop Kombëtar mbi Modernizimin e Legjislacionit dhe Infrastrukturës së Menaxhimit Kolektiv**".

Ky është një aktivitet i cili, u organizua nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale në bashkëpunim me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Aktiviteti ishte i një rëndësie të veçantë sa i takon menaxhimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri, dhe dha mundësinë e marrjes së eksperiencës nga organizatat ndërkombëtare më të fuqishme dhe prestigjioze, që veprojnë në këtë fushë në arenën ndërkombëtare.

- 26 Prill 2010 Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale/ "Trajnim Kombëtar mbi Pronësinë Intelektuale për Autoritetet Shtetërore.
- Me datat 18 -19 Tetor 2010 është kryer një vizite studimore nga dy përfaqësues të Zyres Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) në Zyrat Shtetërore të Pronësisë Intelektuale (SIPO) në Slloveni. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbim eksperience reciproke, por dhe njohje me strukturën, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të kësaj zyre, si dhe kompetencat dhe detyrat e SIPO-s.

- 27-28 Tetor 2010 “ Pronësia Intelektuale për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Avokatë”

Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit së bashku me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (OMPI), organizuan **Trajnimin 2-ditor për Gjykatës, Prokurorë dhe Avokatë për forcimin e zbatimit të të drejtave të Pronësisë Intelektuale.**

Seminari -trajnim ishte i fokusuar për të dhënë një informacion të zgjeruar jo vetëm mbi bazën ligjore të parashikuar në legjislacionin vendas, por edhe mbi atë që konventat dhe tratatet ndërkombëtare në këtë fushë ofrojnë dhe parashikojnë.

Gjatë seminarit u parashtruan dhe kazuse të ndryshme për zgjidhje të cilat ishin një ndihmë nga pikëpamja praktike për stafet e gjyqësorit apo të prokurorisë por dhe stafet e firmave të ndryshme të avokatisë të cilët veprojnë në Shqipëri. Vlen të përmendet një pjesëmarrje e gjerë dhe mjaft e interesuar e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të cilat kanë ndjekur dhe vazhdojnë të ndjekin çështje të cënimit të të drejtës së autorit.

- 9 dhjetor 2010 “ E drejta e autorit në mjedisin dixhital”

Seminari kishte në fokusin e tij kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe menaxhimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në epokën dixhitale, si dhe tema mbi funksionimin e industrive gjigande të muzikës e filmit, si dhe sfidat aktuale mbi sistemin e të drejtave të autorit si dhe modelet e reja të biznesit.

Ekzistenca e piraterisë në epokën dixhitale që jetojmë, parashtron probleme më të mëdha e më serioze sesa riprodhimi fizik apo shpërndarja e veprave artistike. Shqipëria tashmë po jeton moshën e internetit dhe si pasojë i duhet të përshtatet dhe të adaptojë më së miri legjislacionin në fuqi me inovacionet e risitë të cilat kanë zënë vend në realitetin shqiptar.

Gama e të ftuarve ishte e gjerë, kyresisht institucione të tilla shtetërore si Ministria e Teknologjisë dhe e Informacionit, Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së informacionit, Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, kompanitë të shpërndarjes së internetit (Internet Service Provide), kompanitë celulare më të mëdhatë në vend, si dhe institucionet shtetërore të cilët janë pjesë e zinxhirit për zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura.

#### X. Marrëdhëniet me publikun

Në kuadër të aktiviteteve të sipërpërmendura është bërë pasqyrimi i aktivitetit të ZSHDA-së në disa media kryesore.

Është bashkëpunuar me sektorët e tjere dhe me Zyrën e Drejtort të ZSHDA-së edhe për prononcime të ndryshme e për intervista të botuara në disa nga mediat e shkruara të vendit.

PROBLEMATIKË:

***Sa i takon faqes zyrtare të ZSHDA-së kjo për një periudhë të gjatë ka qënë jashtë funksioni për shkak të një virusi që kishtë bllokuar aksesin në të. Ndërkohë është kontraktuar një kompani e cila po bën rindërtimin e faqes dhe rifreskimin e saj me informacion të plotë e të detajuar mbi aktivitetin e përditshëm të ZSHDA-së si dhe do të jetë një udhëzues shumë eficient për të gjithë të intersuarit që kanë nevojë për informacion në këtë fushë.***

### Problematike

Një problem shumë serioz i cili kondicionon në mënyrë të drejtpërdrejtë efektivitetin e zbatimit të ligjit për të Drejtën Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të është problemi i MOS VJELJES SË GJOBAVE.

Ashtu sic Ju jeni në dijeni, ky është një detyrim që jo vetëm buron nga Ligji dhe nga Memorandumi i Bashkëpunimit midis ZSHDA dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, por për më tepër në takimin që Ju patët me Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve Z. Gazmir Spahia, ai mori përsipër personalisht regaim të menjëhershëm në këtë drejtim.

Me anë të një shkrese të DPT njoftohemi se organet tatimore nuk do të ekzekutojnë më gjobat e vendosura nga ZHSDA me arsyetimin e hyrjes në fuqi të Ligjit “Për Kundravajtjet Administrative”, ku kundravajtjet administrative/tituj ekzekutivë do të ekzekutohen nga Zyrrat e Përmbarimit.

Në këto kushte, kur masat administrative që Inspektorët e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit nuk ekzekutohen, efekti i tyre shkon gjithëmonë e më shumë drejt shuarjes dhe rrjedhimisht Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e tjera të lidhura me të mbetet i pazbatuar.

Duke Ju falenderuar për vëmndjen Tuaj , mbetemi në pritje të një reagimi për t`u dhënë zgjidhje problematikave të shumta që respektimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri paraqet.